



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

E.nr.1303/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorit F.H. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson Av Dalip Bega nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria Komunale e Arsimit Ferizaj, për pagesën e pagave të papaguara dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën **E.nr.1303/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1303/23, të datës 01.09.2023 e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, për pagesën e pagave të papaguara dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:167955, të dt.13.03.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës, 09.10.2023 e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 731,95 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1303/23, më datë 16.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi